

VENDIM
Nr. 407, datë 4.7.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE
PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT DHE TË KUTIVE TË MATERIALEVE
ZGJEDHORE TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
TË DATËS 25.6.2017, ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË, TË DATËS
25.6.2017, DHE ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KOLONJË,
TË DATËS 20.11.2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh për përballimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.6.2017, zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kavajë, të datës 25.6.2017, dhe zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kolonjë, të datës 20.11.2016.

2. Efekti financiar prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama